VENDIM
Nr. 458, datë 28.5.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 183, DATË 13.3.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPËRNDARJEN PJESORE TË TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I "HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2" DHE "HEC ULËZ-SHKOPET""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 9 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013', të ligjit nr. 93/2013 "Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë "HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a.", dhe të ligjit nr. 94/2013 "Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë "HEC Ulëz-Shkopet sh.a.", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 183, datë 13.3.2013 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë vijon:

"1. Kufiri i shpenzimeve kapitale, miratuar në ligjin nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", shtohet me 11 965 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) milionë lekë dhe shpërndahet në nivel programi, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Niveli i deficitit buxhetor, miratuar me ligjin nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", shtohet me 11 965 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) milionë lekë dhe, njëkohësisht financimi i deficitit buxhetor nga të ardhurat e privatizimit, shtohet me 11 965 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) milionë lekë.".

b) Lidhja nr. 1 "Shpërndarja e shpenzimeve kapitale sipas programeve", bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1 – Shpërndarja e shpenzimeve kapitale, sipas programeve

Në 000/lekë

Emërtimi/programi	**Shpenzimet kapitale 2013**
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	9.965.000
Transporti rrugor	9.465.000
Furnizimi me ujë dhe kanalizime	500.000
Pushteti vendor	
Granti konkurrues për rrugët rurale	2.000.000
TOTALI	**11.965.000**